

RR E G U L L O R E
për mënyrën, procedurën dhe kushtet për kryerjen e trajnimit dhe dhënien e provimit profesional për kryerjen e veprimtarive të brokerimit

Dispozita të përgjithshme
Neni 1

Kjo Rregullore përshkruan mënyrën, procedurën dhe kushtet për kryerjen e trajnimit dhe dhënien e provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit (në tekstin e mëtejshëm: provim profesional për broker), mënyrën e vlerësimit në pjesën e parë dhe të dytë të provimit, numrin dhe kompleksivitetin e pyetjeve nga pjesa e parë dhe e dytë e provimit profesional, mënyra e krijimit dhe funksionimit të Komisionit për provimin profesional për broker si dhe formën dhe përmbajtjen e vërtetimit për dhënien e provimit profesional për broker.

Organizimi i trajnimit dhe provimit profesional për broker
Neni 2

- (1) Trajnimi dhe provimi profesional për broker organizohet dhe zhvillohet nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia).
- (2) Detyrat profesionale dhe administrative me qëllim të mbajtjes së provimit profesional i kryen Agjencia, ku Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë cakton një person përgjegjës, i cili përcakton nëse kandidati i plotëson kushtet për dhënien e provimit profesional.
- (3) Provimi profesional për broker zhvillohet teknikisht nga një person juridik i zgjedhur nga Agjencia.

Shpallja e kohës dhe vendit të mbajtjes së trajnimit dhe dhënies së provimit profesional për broker

Neni 3

- (1) Trajnimi dhe provimi profesional për broker hillohen në bazë të nevojës të konstatuar, por të paktën një herë në vit.

(2) Agjencia nuk mund të zhvillojë trajnimin dhe provimin profesional për broker, nëse nuk kanë aplikuar të paktën 5 (pesë) kandidatë.

(3) Koha dhe vendi për mbajtjen e trajnimit dhe dhënien e provimit profesional për broker përmes njoftimit publikohen në faqen e Agjencisë dhe në një gazetë ditore të botuar në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë.

Mënyra e mbajtjes së trajnimit për dhënien e provimit profesional për broker

Neni 4

(1) Trajnimi për dhënien e provimit profesional për broker do të bëhet në përputhje me Kurrikulën për dhënien e provimit profesional për kryerjen e veprimtarive të brokerimit të sigurimeve të përcaktuara nga Agjencia dhe përmbajnë materialet, rregulloret dhe literaturën e nevojshme.

(2) Trajnimi për dhënien e provimit profesional për përfaqësues duhet të ketë gjithsej 27 orë mësimore.

Edukatorët

Neni 5

(1) Trajnimi për dhënien e provimit profesional për broker zhvillohet nga pedagogë (edukatorë) të angazhuar nga Agjencia, të cilët kanë arsim universitar dhe përvojë pune dhjetëvjeçare në fushën përkatëse për të cilën do të japin mësim.

(2) Në mbajtjen e trajnimit për dhënien e provimit profesional për broker, mund të marrin pjesë edhe ekspertë të njohur nga kjo praktikë, si nga vendi dhe jashtë vendit.

(3) Për përzgjedhjen e pedagogëve (edukatorëve), Agjencia publikon ftesë për parashtrimin e ofertave në faqen e saj të internetit dhe në faqen e internetit të sistemit elektronik të furnizimeve publike.

(4) Përzgjedhja e pedagogëve (edukatorëve) bëhet nga Agjencia, në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ekspertëve dhe publikohet në ftesën për parashtrimin e ofertave.

(5) Lista e pedagogëve/edukatorëve të përzgjedhur publikohet në faqen e internetit të Agjencisë.

(6) Edukatorët janë të detyruar të zhvillojnë trajnime (leksione) për modulën lëndor për të cilin ata përzgjidhen nga Agjencia dhe në përputhje me Kurrikulën për dhënien e provimit profesional për broker.

(7) Edukatorët janë të detyruar të zhvillojnë trajnimin (leksionet) sipas orarit të përcaktuar nga Agjencia.

(8) Edukatorët janë të detyruar të përgatisin një listë të pyetjeve të provimeve dhe përgjigjet e tyre dhe shembuj praktikë dhe përgjigjet e tyre në përputhje me kriteret e përcaktuara me ligj, t'i regjistrojnë ato në sistemin e vetëm elektronik për marrjen e provimit profesional për kryerjen e aktivitetit të brokerimit të sigurimeve në fushën e duhur dhe t'i dorëzojnë me shkrim në Agjenci brenda afatit të përcaktuar nga Agjencia.

Kushte për pjesëmarrje në trajnim dhe dhënien e provimit profesional për broker

Neni 6

- (1) Të drejtën që të marrin pjesë në trajnim dhe të japin provimin profesional për broker e kanë kandidatët që kanë përfunduar së paku arsimin e mesëm.
- (2) Kandidati i paraqet Agjencisë, brenda afatit të përcaktuar në shpalljen për kryerjen e trajnimit dhe provimit profesional për broker, një kërkesë për pjesëmarrje në trajnim dhe dhënien e provimit profesional për përfaqësues në formularin "Kërkesë për pjesëmarrje në trajnim dhe dhënien e provimit profesional për broker" (Formulari për Provim- Trajnim Profesional për Broker T-PPB) " i cili është dhënë në Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.
- (3) Kandidati i cili flet gjuhë zyrtare, të ndryshme nga gjuha maqedonase, i paraqet Agjencisë, brenda afatit të përcaktuar në shpalljen për kryerjen e trajnimit dhe provimit profesional për përfaqësues, një kërkesë për pjesëmarrje në trajnim dhe dhënien e provimit profesional për broker në formularin "Kërkesë për pjesëmarrje në trajnim dhe dhënien e provimit profesional për broker" (Formular për T-PPB / Kërkesë për pjesëmarrje në trajnimin dhe promovimin profesional për broker Formulari T-PPB) që është pjesë përbërëse e saj
- (4) Bashkangjitur me kërkesën/aplikimin për pjesëmarrje në trajnimin dhe dhënien e provimit profesional për broker nga paragrafi (1) respektivisht (2) nga ky nen, kandidati e parashtron dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kopje e dokumentit të identifikimit personal;
2. Diploma ose Vërtetimi për përfundimin e arsimit të mesëm ose arsimit tjetër të lartë i lëshuar nga një institucion arsimor i akredituar në Republikën e Maqedonisë - me kopje origjinale ose të noterizuar dhe
3. Vërtetim për tarifën e paguar për pjesëmarrje në trajnime dhe dhënien e provimit profesional për përfaqësues në përputhje me Listën e Tarifës së Agjencisë.

(5) Nëse kandidati ka mbaruar arsimin e tij jashtë vendit, atij i kërkohet të paraqesë një Diplomë / Vërtetim të Arsimit të Mesëm ose arsim tjetër të lartë të lëshuar nga një institucion arsimor i akredituar jashtë vendit, së bashku me një dokument që njih

shkollën e mesme të huaj ose kualifikimin universitar të lëshuar nga institucioni kompetent në Republikën e Maqedonisë.

(6) Nëse emri dhe mbiemri personal i personit të përmendur në paragrafin (2) pika 1 nuk është identik me emrin personal dhe mbiemrin e personit të përmendur në dokumentin nga paragrafi (2) pika 2, do të jetë e nevojshme që personi të paraqesë certifikatë martese nga regjistri i amzës respektivisht vendim për të ndryshuar emrin ose mbiemrin tuaj personal.

(7) Kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet për trajnim dhe dhënien e provimit profesional për broker, Agjencia jep vendim për plotësimin e kushteve për pjesëmarrje në trajnim dhe dhënien e provimit profesional për broker.

Provimi profesional për broker

Neni 7

(1) Provimi profesional për broker përbëhet nga dy pjesë:

- 1) Pjesa e parë (pjesa teorike) ku verifikohet njohuria teorike e kandidatëve; dhe
- 2) Pjesa e dytë (shembuj praktikë) me të cilët verifikohet aftësia për zbatimin e ligjeve në praktikë.

(2) Pjesa e parë e provimit profesional për broker bëhet në lëndët vijuese:

- 1.1 Bazat e Menaxhimit të Rrezikut dhe Sigurimeve
- 1.2 Legjislacioni i sigurimeve
- 1.3 E drejta tregtare dhe obligative
- 1.4 Ndërmjetësim në Sigurime dhe Kodi i Etikës
- 1.5 Sigurimi i jetës dhe
- 1.6 Sigurimi jo-jetë.
- 1.7 Aspektet financiare të aktivitetit
- 1.8 Regjistrimi i rrishtit dhe ndërmjetësimi gjatë realizimit të dëmeve
- 1.9 Risigurimi

(3) Pjesa e dytë e provimit profesional për broker përbëhet nga:

- 1) Shembull praktik;
- 2) Pyetjeve të cilat kandidati duhet t'i përgjigjet bazuar në një shembull praktik.

(4) Pjesa e dytë e provimit profesional për broker do të jepet për të gjitha lëndët nga pjesa e parë e provimit profesional për broker.

(5) Përmbajtja e detajuar e secilës prej lëndëve nga pjesa e parë e provimit profesional për broker është elaboruar në Kurrikulën për dhënien e provimit profesional për broker dhe përmban kurrikulën, rregulloret dhe literaturën.

(6) Agjencia e boton planin mësimor për Provimin Profesional në faqen e saj të internetit.

Pjesa e parë (teorike) e provimit profesional për broker Neni 8

(1) Provimi profesional për broker fillon me dhënien e pjesës së parë (teorike) të provimit.

(2) Pjesa e parë (teorike) e provimit profesional për broker jepet me shkrim në formë elektronike duke iu përgjigjur pyetjeve në formën e zgjidhjes së një testi elektronik në kompjuter.

(3) Pjesa e parë (teorike) e provimit profesional për broker përmban gjithsej 45 pyetje, përkatësisht 5 pyetje për secilën nga lëndët nga Pjesa e Parë e provimit profesional për broker.

(4) Secila pyetje përbëhet nga 5 mundësi të ofruara për përgjigje, nga të cilat njëra është e saktë, dy janë të ngjashme dhe dy janë të pasakta.

(5) Secila përgjigje e saktë e një pyetje vlerësohen me 1 (një) pikë, përgjigjet e ngjashme dhe të pasakta nuk vlerësohen.

(6) Kandidati ka kaluar pjesën e parë (teorike) të provimit profesional për broker nëse ka marrë të paktën 70% të numrit të përgjithshëm të pikëve, d.m.th. nëse ka marrë të paktën 63 pikë.

(7) Kandidatit nuk i lejohet të përdorë ligje ose ligje me komente dhe shpjegime gjatë pjesës së parë (teorike) të provimit për broker.

(8) Kohëzgjatja totale e pjesës së parë (teorike) të provimit profesional për broker është 120 minuta.

(9) Rezultatet nga dhënia e pjesës së parë të provimit profesional për broker do të jenë të disponueshme për kandidatin në kompjuterin në të cilin ai/ajo ka dhënë provimin, menjëherë pas përfundimit të tij.

Pjesa e dytë (shembull praktik) nga provimi profesional për broker Neni 9

- (1) Pjesa e dytë (shembulli praktik) nga provimi profesional për broker jepet të paktën 15 ditë pas kalimit me sukses të pjesës së parë (teorike) të provimit profesional për broker.
- (2) Kandidati i cili nuk ka kaluar pjesën e parë (teorike) të provimit profesional për broker nuk mund të marrë pjesën e dytë (shembullin praktik) të provimit profesional për broker.
- (3) Pjesa e dytë (shembulli praktik) i provimit profesional për broker jepet me shkrim duke studiuar 9 shembuj praktikë, nga një shembull praktik nga secila lëndë. Çdo shembull praktik përmban 1 pyetje me 5 opsione të ofruara për qarkim, nga të cilat një është i saktë, dy janë të ngjashëm dhe dy janë të pasakta.
- (4) Secila përgjigje e saktë e një pyetje vlerësohet me 5 (pesë) pikë, përgjigjet e ngjashme dhe të pasakta nuk vlerësohen.
- (5) Kandidati e ka marrë pjesën e dytë (shembullin praktik) të provimit profesional nëse ka arritur të përvetësojë 70% të numrit të përgjithshëm të pikëve, gjegjësisht nëse ka përvetësuar të paktën 63 pikë.
- (6) Kandidati gjatë pjesës së dytë (shembulli praktik) i provimit profesional për broker i lejohet të përdorë vetëm ligje (pa komente dhe shpjegime) të cilat janë në formë elektronike në kompjuterin në të cilin kandidati bën provimin, një kalkulator dhe një stilolaps.
- (7) Kohëzgjatja totale e pjesës së dytë (shembulli praktik) i provimit profesional për broker është 120 minuta.
- (8) Rezultatet nga pjesa e dytë (e shembulli praktik) të provimit profesional për broker do t'i vihen në dispozicion kandidatit në kompjuterin në të cilin ai/ajo e mbajti provimin, menjëherë pas përfundimit të tij.

Neni 10

- (1) Konsiderohet se kandidati e ka dhënë provimin profesional për broker nëse e ka dhënë pjesën e parë (teorinë) dhe pjesën e dytë (shembullin praktik) nga provimi profesional për broker në kuadër të një provimi.
- (2) Kandidati i cili nuk e ka kaluar provimin profesional për broker me dhënien e parë të provimit ka të drejtën dy herë të japë provimin profesional në afat prej gjashtë muajsh nga dita e përfundimit të trajnimit.
- (3) Kandidati i cili tre herë rradhazi nuk e ka dhënë provimin profesional për broker e humb të drejtën e dhënies përsëri të provimit profesional të parashikuar me trajnim.

(4) Personat nga paragrafi (3) i këtij neni kanë të drejtën që të paraqiten në trajnimin vijues, në mënyrën dhe nën kushtet e konfirmuara me këtë rregullore.

Komisioni për mbajtjen e provimit profesional për broker Neni 11

(1) Komisionin për mbajtjen e provimit profesional për broker e formon Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë (në tekstin e mëposhtëm (Komisioni)).

(2) Komisioni i verifikon pyetjet për provimin profesional për broker.

(3) Komisioni kryen edhe auditimin dhe azhurnimin e bazës bulikisht të aksesueshme të pyetjeve për mbajtjen e provimit profesional për broker.

Procedurë për zbatimin e provimit profesional për broker Neni 12

(1) Kandidati të cilit me vendim i është aprovuar kërkesa për të dhënë provimin profesional për broker në sigurime, informohet përmes ueb faqes të Agjencisë dhe Shërbimit të Transmetimit Publik për kohën dhe vendin e mbajtjes së provimit profesional për broker jo më vonë se 8 ditë përpara dhënies të provimit profesional për broker.

(2) Kandidatit të cilit me vendim i është miratuar kërkesa për dhënien e provimit profesional për broker në sigurime, duhet t'i lejohet të japë provimin profesional për broker në ditën e parë pasuese të ditës së aplikimit të miratuar për dhënien e provimit profesional për broker në sigurime.

Neni 13

(1) Provimi profesional për broker fillon në kohën e saktë të përcaktuar dhe zgjat në përputhje me kohën e përcaktuar në këtë Rregullore.

(2) Vonesa në provim mund të tolerohet vetëm nëse kanë kaluar jo më shumë se 10 minuta nga fillimi i provimit për shkaqe të arsyeshme.

(3) Provimi profesional për broker zhvillohet në hapësirën për provim, e pajisur posaçërisht për dhënien e provimit profesional për përfaqësues me pajisje teknike dhe informative, lidhje interneti dhe regjistrimin e provimit.

- (4) Dhënia e provimit profesional për broker regjistrohet dhe transmetohet drejtpërdrejt në faqen e internetit të Agjencisë, dhe nëse për arsye teknike regjistrimi ndërpritet, regjistrimi i tërë provimit do të postohet në faqen e internetit të Agjencisë.
- (5) Në hapësirën e mbajtjes së provimit profesional për broker, gjatë provimit janë të pranishëm dy përfaqësues të autorizuar të Agjencisë, anëtarë të Komisionit për mbajtjen e provimit profesional për broker, një përfaqësues nga Ministria e Financave, një përfaqësues nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë dhe një ekspert të IT të emëruar nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.
- (6) Mjediset dhe kushtet për mbajtjen e provimit profesional për broker i siguron një person juridik i veçantë me të cilin Agjencia ka lidhur një marrëveshje që plotëson kërkesat hapësinore dhe pajisjet teknike dhe informative të materialeve në ambientet për mbajtjen e provimit të përcaktuara nga Agjencia.

Neni 14

- (1) Para fillimit të mbajtjes së provimit profesional për broker, përfaqësuesi i autorizuar i Agjencisë përcakton identitetin e kandidatit duke verifikuar kartën e tij të identitetit ose dokumentin e udhëtimit.
- (2) Kandidatit gjatë dhënies së provimit profesional për broker nuk i lejohe të përdorë telefon celular, pajisje kompjuterike portative dhe pajisje të tjera teknike dhe informative, objekte të përgatitura paraprakisht dhe të ngjashme si këto.
- (3) Kandidatit gjatë dhënies së provimit profesional për broker, nuk i lejohe të kontaktojë me kandidatë ose persona të tjerë përveç se me zyrtarin e IT-së nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, nëse ka një problem teknik me kompjuterin.
- (4) Nëse problemet teknike me kompjuterin janë eliminuar brenda pesë minutave, provimi profesional për broker vazhdon dhe nëse nuk janë eliminuar brenda kësaj periudhe, provimi profesional për broker ndërpritet vetëm për këtë kandidat dhe zhvillohet brenda tre ditësh nga data e ndërprerjes së provimit profesional për broker.
- (5) Nëse ka probleme me më shumë se pesë kompjutera dhe nëse ato nuk evitohen brenda pesë minutave, provimi profesional për broker pezullohet për të gjithë kandidatët që marrin pjesë në provimin profesional për broker dhe mbahen brenda tre ditëve nga dita e ndërprerjes së provimit profesional për broker.
- (6) Nëse kandidati gjatë provimit vepron në kundërshtim me paragrafin (2) dhe paragrafin (3) të këtij neni, atij nuk i lejohe të japë provimin profesional për broker në këtë sezon provimi.

(7) Në rastet nga paragrafi (6) i këtij neni, konsiderohet se kandidati nuk e ka marrë provimin profesional për broker dhe ai duhet të evidentohet në procesverbalin për dhënien e provimit profesional për broker.

(8) Personat nga neni 13 paragrafi (5) i kësaj Rregulloreje, gjatë dhënies së provimit profesional për broker, nuk duhet të qëndrojnë për më shumë se pesë sekonda në afërsi të kandidatit që jep provimin profesional për broker, përveç në rast të evitimit të një problemi teknik kur nuk mund të qëndrojnë për më shumë se pesë minuta.

Neni 15

- (1) Në ditën e dhënies së provimit profesional për broker, përfaqësuesi i Agjencisë i jep kandidatit një kod hyrje ose fjalëkalim, i cili do t'i lejojë atij akses në sistemin elektronik.
- (2) Pas miratimit të hyrjes, kandidati do të marrë një test elektronik për provimin profesional për broker të gjeneruar në kompjuter, përmbajtja e së cilit përcaktohet rastësisht nga programi i sistemit elektronik, nga baza e të dhënave publike të pyetjeve.
- (3) Pjesa e parë dhe e dytë e provimit profesional për broker përmbajnë udhëzime për mënyrën e zgjidhjes së tij për të cilin përfaqësuesi i Agjencisë jep sqarime para se të fillojë provimi profesional për broker.
- (4) Sistemi elektronik për dhënien e provimit profesional për broker nuk mund të lejojë ekzistencën e përmbajtjes identike të testit elektronik për pjesën e parë të provimit, gjegjësisht shembullin praktik dhe pyetjet dhe /ose detyrat për pjesën e dytë të provimit për më shumë se një kandidat.

Neni 16

- (1) Në rast të pamundësisë së kryerjes së pjesës së parë ose të dytë të provimit profesional për broker, për arsye që çojnë në pamundësinë teknike të funksionimit të sistemit elektronik, dhënia e provimit profesional për përfaqësues ndërpritet.
- (2) Nëse arsyet nga paragrafi (1) i këtij neni eliminohen brenda 60 minutave nga ndërprerja e provimit profesional për broker, ai do të vazhdojë menjëherë pas evitimit të tyre.
- (3) Nëse arsyet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk janë evituar brenda afatit të përmendur në paragrafin (2) të këtij neni, provimi profesional për broker ricaktohet për një sezon tjetër.

Neni 17

- (1) Pas përfundimit të provimit profesional për broker, Komisioni përpilon proces verbal.
- (2) Procesverbalin e nënshkruajnë anëtarët e Komisionit për mbajtjen e provimit profesional për broker që marrin pjesë në mbajtjen e provimit profesional për broker.

Publikimi i rezultateve

Neni 18

Agjencia brenda 5 ditëve nga dita e mbajtjes së pjesës së dytë të provimit profesional për broker në veb faqen e saj publikon listën e kandidatëve që e kanë dhënë provimin profesional për broker.

Vërtetim për dhënien e provimit profesional për broker në sigurime

Neni 19

- (1) Agjencia lëshon një Vërtetim për dhënien e provimit profesional për broker në sigurime për kryerjen e veprimtarive të sigurimit brenda 15 ditëve nga dita kur është përcaktuar se e ka kaluar provimin profesional për broker.
- (2) Vërtetimi për dhënien e provimit profesional për kryerjen e veprimtarive të brokerimit të sigurimeve përmban:
 1. Emrin dhe mbiemrin e plotë të kandidatit;
 2. Viti dhe vendi i lindjes së kandidatit;
 3. Data e marrjes së provimit profesional për broker;
 4. Numri dhe data e lëshimit të Vërtetimit nga dhënia e provimit profesional për broker të sigurimeve dhe
 5. Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i Kryetarit të Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve.
- (3) Forma dhe përmbajtja e Certifikatës për provimin e dhënë për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit në sigurime, e shtypur në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik është rregulluar me Formular të veçantë: Certifikata për provimin e dhënë për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit në sigurime që është dhënë në Aneksin 3 nga rregullorja dhe është pjesë përbërëse e saj.
- (4) Forma dhe përmbajtja e Certifikatës për provimin e dhënë për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit në sigurime që flet gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, është rregulluar me Formular të veçantë: “Уверение за положен стручен испит за вршење на работи на застапување во осигурување/ Certifikata për provimin e dhënë për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit në sigurime”, që është dhënë në Aneksin 4 nga rregullorja dhe është pjesë përbërëse e saj.

АГЕНЦИЈА ЗА СУПЕРВИЗИЈА НА ОСИГУРУВАЊЕ


ПРИЈАВА¹
КËРКЕСË⁴
ЗА УЧЕСТВО НА ОБУКА И ПОЛАГАЊЕ НА СТРУЧЕН ИСПИТ ЗА БРОКЕР

1.	Име и презиме	
2.	Датум и место на раѓање (од лична карта)	
3.	Адреса на живеење (од лична карта)	
4.	ЕМБГ	
5.	Контакт телефон (мобилен)	
6.	Адреса на електронска пошта (е-маил) на која лицето се согласува да биде контактиран во врска со пријавата	

Се пријавувам за учество на обука и полагање на стручен испит за брокер. Кон пријавата ја приложувам документацијата согласно членот 6 став (2) од Правилникот за начинот, постапката и условите за спроведување на обука и полагање на стручен испит за брокер и тоа *(се заокружува односно означува доколку се пополнува електронски)*:

1.	Копија од документ за лична идентификација ²
2.	Диплома или Уверение за завршено четиригодишно средно образование или друг повисок степен на образование издадена од образовна институција акредитирана во Република Северна Македонија – во оригинал или нотарски заверена копија ³
3.	Доказ за платен надоместок за учество на обука и полагање на стручен испит за брокер согласно Тарифникот на Агенцијата.

ИЗЈАВА НА ПОДНОСИТЕЛОТ НА БАРАЊЕТО

Со поднесување на оваа пријава изјавувам дека податоците и информациите што ги содржи оваа пријава, како и целата документација која ја доставувам кон пријавата, се точни и не содржат фалсификувани податоци и документи а во случај на промена на податоците содржани во оваа пријава, како и во документацијата доставена во прилог кон оваа пријава, во рок од 3 работни дена од настанувањето на

¹ Се препорачува Пријавата да се пополнува електронски. Електронска верзија на Пријавата може да се најде на официјалната интернет-страница на Агенцијата за супервизија на осигурување www.aso.mk. Доколку Пријавата не се пополнува електронски, задолжително треба да се користи пенкало и да се пишува со големи букви.

² Доколку личното име и презиме на лицето на документот за лична идентификација не е идентично со личното име и презиме на лицето наведено во документот од точка 2, лицето е должно да приложи и Извод од матична канига на венчани односно Решение за промена на личното име односно презиме.

³ Доколку лицето школувањето го завршил во странство потребно е кон пријавата да достави Диплома/Уверение за завршено четиригодишно средно образование или друг повисок степен на образование издадена од образовна институција акредитирана во странство заедно со документ за признавање на странска средношколска или универзитетска квалификација издадена од страна на надлежна институција во Република Северна Македонија.

промената ќе ја известам Агенцијата. Се согласувам моите лични податоци содржани во оваа пријава да се користат согласно прописите на Законот за заштита на лични податоци.

Датум и место на поднесување

Потпис на подносителот на пријавата

____.____20____ година/ _____

АГЕНЦИЈА ЗА СУПЕРВИЗИЈА НА ОСИГУРУВАЊЕ



AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

ПРИЈАВА⁴
ЗА УЧЕСТВО НА ОБУКА И ПОЛАГАЊЕ НА СТРУЧЕН ИСПИТ ЗА БРОКЕР
КËРКЕСË⁴
ПËР ПЈЕСËМАРРЈЕ НË ТРАЈНИМИН ДНЕ PROVIMIN PROFESIONAL ПËР BROKER

1.	Име и презиме Emri dhe mbiemri	
2.	Датум и место на раѓање (од лична карта) Data dhe vendi i lindjes (sipas letërnjoftimit)	
3.	Адреса на живеење (од лична карта) Adresa e vendbanimit (sipas letërnjoftimit)	
4.	ЕМБГ Numri Personal i Identifikimit të Qytetarit (NPIQ)	
5.	Контакт телефон (мобилен) Telefon për kontakt (celular)	
6.	Адреса на електронска пошта (е-маил) на која лицето се согласува да биде контактиран во врска со пријавата Adresa e postës elektronike (e-mail) në të cilën personi pajtohet që të kontaktojë lidhur me aplikimin	

Се пријавувам за учество на обука и полагање на стручен испит за брокер. Кон пријавата ја приложувам документацијата согласно членот 6 став (2) од Правилникот за начинот, постапката и условите за спроведување на обука и полагање на стручен испит за брокер и тоа (се заокружува односно означува доколку се пополнува електронски):

Апликој пѐр пјесѐмarrje нѐ трајнимин dhe provimin професионал пѐр брокер. Нѐ документин e апликит e bashkangjit edhe документационин нѐ pajtim me nenin 6 paragrafi (2) nga Rregullorja пѐр мѐнyрѐн, procedurѐн dhe kushtet пѐр zbatimin e trajnimit dhe dhѐnien e provimit професионал пѐр брокер dhe kjo (finalizohet нѐсе plotѐsohet нѐ мѐнyрѐ електронике)

1.	Копија од документ за лична идентификација ⁵
----	---

⁴ Се препорачува Пријавата да се пополнува електронски. Електронска верзија на Пријавата може да се најде на официјалната интернет-страница на Агенцијата за супервизија на осигурување www.aso.mk. Доколку Пријавата не се пополнува електронски, задолжително треба да се користи пенкало и да се пишува со големи букви.

Rekomandohet që Kërkesa пѐр апликит нѐ plotѐsohet нѐ мѐнyрѐ електронике. Versioni elektronik i Kërkesës ѐshtѐ нѐ faqen zyrtare тѐ internetit тѐ Agjencisë пѐр Mbiqëryrje тѐ Sigurimeve www.aso.mk. Nѐсе Kërkesa nuk plotѐsohet нѐ formѐ електронике ,duhet тѐ plotѐsohet patjetѐr me stilolaps dhe тѐ shkruhet me shkronja тѐ мѐдha .

	Kopje e dokumentit për identifikim personal ⁵
2.	Диплома или Уверение за завршено четиригодишно средно образование или друг повисок степен на образование издадена од образовна институција акредитирана во Република Северна Македонија – во оригинал или нотарски заверена копија ⁶ Diplomë ose Vërtetim për përfundimin e arsimit të mesëm ose arsimimit të lartë të dhënë nga institucioni i akredituar në Republikën e Maqedonisë së Veriut – origjinali ose kopje e noterizuar ⁶
3.	Доказ за платен надоместок за учество на обука и полагање на стручен испит за брокер согласно Тарифникот на Агенцијата. Argument për kompensim të paguar për pjesëmarrje në trajnim dhe dhënien e provimit për broker konform Listës së Tarifave të Agjencisë.

ИЗЈАВА НА ПОДНОСИТЕЛОТ НА БАРАЊЕТО ДЕКЛАРАТË Е PARASHTRUESIT ТË КËРКЕСËС

Со поднесување на оваа пријава изјавувам дека податоците и информациите што ги содржи оваа пријава, како и целата документација која ја доставувам кон пријавата, се точни и не содржат фалсификувани податоци и документи а во случај на промена на податоците содржани во оваа пријава, како и во документацијата доставена во прилог кон оваа пријава, во рок од 3 работни дена од настанувањето на промената ќе ја известам Агенцијата. Се согласувам моите лични податоци содржани во оваа пријава да се користат согласно прописите на Законот за заштита на лични податоци.

Me parashtrimin e kësaj kërkesë deklaroj se të dhënat dhe informacionet që i përmban kjo kërkesë, si dhe i gjithë dokumentacioni të cilin e parashtrorj bashkë me Kërkesën, janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të falsifikuara, ndërsa në rast të ndryshimit të të dhënave që janë në këtë kërkesë, si dhe të dokumentacionit të parashtruar në bashkangjitje të kësaj kërkesë, për ndryshimin e bërë do ta njoftoj Agjencinë në afat kohor prej 3 ditë pune. Pajtohem që të dhënat e mia personale të cilat janë në këtë kërkesë të përdoren në pajtim me rregullat e Ligjit për Mbrojtje të të Dhënave Personale.

⁵ Доколку личното име и презиме на лицето на документот за лична идентификација не е идентично со личното име и презиме на лицето наведено во документот од точка 2, лицето е должно да приложи и Извод од матична канига на венчани односно Решение за промена на личното име односно презиме.

Nëse emri dhe mbiemri i personit në dokumentin e identifikimit personal nuk është identik me emrin dhe mbiemrin e personit të parashtruar në dokumentin e pikës 2, personi është i detyruar që të deponojë edhe Certifikatë martesë respektivisht për ndryshimin e emrit personal respektivisht mbiemrit.

⁶ Доколку лицето школувањето го завршил во странство потребно е кон пријавата да достави Диплома/Уверение за завршено четиригодишно средно образование или друг повисок степен на образование издадена од образовна институција акредитирана во странство заедно со документ за признавање на странска средношколска или универзитетска квалификација издадена од страна на надлежна институција во Република Северна Македонија.

Nëse personi shkollimin e ka përfunduar jashtë vendit nevojitet që bashkë me kërkesën të parashtrorj edhe Diplomë/Vërtetim për përfundimin e arsimit të mesëm ose arsimimit të lartë të dhënë nga institucioni arsimor i akredituar jashtë vendit së bashku me dokumentin për njohjen e kualifikimit të arsimit të mesëm apo të lartë jashtë vendit të lëshuar nga ana e institucionit kompetent në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

ПРИЛОГ 3- Образец Уверение за положен стручен испит за вршење осигурително брокерски работи

**Република Северна Македонија
АГЕНЦИЈА ЗА СУПЕРВИЗИЈА НА
ОСИГУРУАЊЕ**



У В Е Р Е Н И Е
за положен стручен испит за вршење за вршење
осигурително брокерски работи

Лицето

_____ (Име, презиме, датум и година на раѓање)

на _____ година го положи стручниот испит за вршење осигурително брокерски работи

Број УП _____
_____ година

ПРЕТСЕДАТЕЛ НА СОВЕТОТ НА ЕКСПЕРТИ

М.П.

ПРИЛОГ 4/ FORMULARI 4- Образец Уверение за положен стручен испит за вршење осигурително брокерски работи/Formulari Certifikatë për dhënien e provimit profesional për kryerjen e aktiviteteteve të brokerimit në sigurime

Република Северна Македонија
АГЕНЦИЈА ЗА СУПЕРВИЗИЈА НА ОСИГУРУАЊЕ



Republika e Maqedonisë së Veriut
AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

У В Е Р Е Н И Е
за положен стручен испит за вршење на осигурително
брокерски работи
CERTIFIKATË
për dhënien e provimit profesional për kryerjen e aktiviteteteve
të brokerimit në sigurime

Лицето/Personi

_____ (Име, презиме, датум и година на раѓање/emri, mbiemri, data e lindjes)

на/мë _____ година/viti го положи стручниот испит за вршење работи на застапување во осигурување/e kaloi me sukses provimin profesional për përfaqësues në sigurime.

Број УП/Numër PA

ПРЕТСЕДАТЕЛ НА СОВЕТОТ НА ЕКСПЕРТИ
KRYTEARTI I KËSHILLIT TË EKSPERTËVE

1. _____ година/viti

м.п./v.n.